

# NEWSLETTER

## ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

### LICENCIME

### RAPORTI VJETOR

#### Gjatë muajve qershor - korrik, Enti Rregullator i Energjisë ka filluar procedurat e licencimit për subjektet e mëposhtme:

- 1.“EU GREEN ENERGY” shpk, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, procedurë e cila u finalizua me vendimin Nr. 231, Datë 19.07.2023;
- 2.“SPV BLUE 1” shpk, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, procedurë e cila u finalizua me vendimin Nr. 232, Datë 19.07.2023;
- 3.“SPV BLUE 1” shpk, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, procedurë e cila u finalizua me vendimin Nr. 233, Datë 19.07.2023;
- 4.“HYDRO SETA” shpk për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, procedurë e cila u finalizua me vendimin Nr. 234, Datë 19.07.2023
- 5.“G.S.K” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier, procedurë e cila u finalizua me vendimin Nr. 254, Datë 23.08.2023
- 6.“GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” shpk, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, procedurë e cila u finalizua me vendimin Nr. 238, Datë 27.07.2023;
- 7.“ALB SUN ENERGY” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier, (ende në shqyrtim);
- 8.“Erseka Solar Park 2” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 MW (AC), me vendndodhje në fshatin Starje, Njësia Administrative Qendër Ersekë, Bashkia Kolonjë, Qarku Korçë, procedurë e cila u finalizua me vendimin Nr. 253, Datë 23.08.2023.

U PREZANTUA GJATË SEANCËS PLENARE TË DATËS 13 KORRIK 2023, NË KUVENDIN E SHQIPËRISË, RAPORTI VJETOR MBI SITUATËN E SEKTORIT TË ENERGJISË DHE VEPRIMTARITË E ERE-S PËR VITIN 2022. GJATË FJALËS SË TIJ KRYETARI, Z.PETRIT AHMETI PARAQITI NË MËNYRË TË PËRMBLEDHUR VËSHTIRËSITË E HASURA GJATË VITIT 2022 NË SEKTORIN ENERGJITIK, MASAT E MARRA NË NDIHMË TË SITUATËS ME TË CILËN U PËRBALL KY SEKTOR, SI DHE VENDIMARRJE TË CILAT SIGURUAN PËRBALLIMIN ME SUKSES TË KRIZËS ENERGJITIKE DHE GARANTIMIN E FURNIZIMIT TË PANDËRPRERË ME ENERGJI ELEKTRIKE NË TË GJITHË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PA KOSTO SHITESË PËR KONSUMATORIN. Z. AHMETI, GJITHASHTU, BËRI NJË PASQYRË TË PUNËS SË PËRDITSHME TË ERE-S, RRETH LICENCIMEVE TË SUBJEKTEVE TË NDRYSHME, MONITORIMEVE TË SEKTORIT, VENDIMARRJET PËR DIVERSIFIKIMIN E BURIMEVE TË PRODHIMIT TË ENERGJISË, PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË NDRYSHME NË SEKTOR, ECURISË NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR DHE BASHKËPUNIMIT ME TAP, MBROJTJEN E KONSUMATORIT ETJ., INFORMACIONE TË DETAJUARA RRETH TË CILAVE MUND TI SHFLETONI NË RAPORTIN E VJETOR TË ERE PËR VITIN 2022 NË LINKUN E MËPOSHTËM:

**[LEXO MË SHUMË](#)**

# NEWSLETTER

## ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

### VENDIME

### MBLEDHJE BORDI

Gjatë muajve qershor dhe korrik Bordi i ERE-s ka zhvilluar 8 (tetë) mbledhje, prej të cilave kanë rezultuar 35 vendimmarrje, nga të cilat janë licencuar 2 (dy) subjekte në aktivitetin e Furnizimi i Energjisë Elektrike, 4 (katër) subjekte në aktivitetin e Tregëtimit i Energjisë Elektrike, si dhe është miratuar njohja e 2 (dy) licencave nga subjekte të huaja me degë në Shqipëri. Ndër vendime me rëndësi gjatë muajve qershor – korrik mund të përmendim gjithashtu:

Vendimin e Bordit të ERE Nr. 186, Datë 06.06.2023 mbi miratimin e kërkesës e Shoqatës së Furnizuesve të Energjisë, AAES, për disa ndryshime dhe kufizime në zbatimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 23, datë 14.02.2022, "Mbi miratimin e rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit". Nëpërmjet kësaj vendimmarrje, ERE, pasi vlerësoi kërkesën e shoqatës AAES dhe konsultoi me palët e interesit, vendosi që, detyrimi për implementimin e disa masave të parashikuara në disa dispozita të Rregullores të fillojnë nga data 31.12.2023. ERE, vlerësoi se, ky vendim nuk impakton konsumatorin shqipëtar, në sigurimin e një shërbimi cilësor ndaj klientit.

Vendimin e Bordit të ERE Nr. 189, Datë 06.06.2023 mbi rinovimin e licencës së shoqërisë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 04.09.2023.

Vendimin e Bordit të ERE Nr. 194, Datë 19.06.2023 mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sh.a., për muajin Maj 2023, prej 16.41 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

Vendimin e Bordit të ERE Nr. 222, Datë 10.07.2023 ERE mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sh.a., për muajin Qershor 2023, prej 14.22 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

Vendimin e Bordit të ERE Nr.226, Datë 14.07.2023, mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë FSHU sh.a., për rishikimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për subjektet që ushtrojnë aktivitetin "Furra Buke dhe/ose Prodhim Mielli.

Vendimin e Bordit të ERE Nr.227, Datë 14.07.2023 mbi miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren e procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit, marrëveshjen e operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 87, datë 20.4.2018. Për këtë vendimarrje të Bordit të ERE do të njoftohet Ministria e Infstrukturës dhe Energjisë, shoqëria OST sh.a. dhe palët e interesit.

# NEWSLETTER

## ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

### BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE - ALPEX



Në datën 17 korrik 2023, gjatë mbledhjes së përbashkët të zhvilluar në Prishtinë, Bordi i ERE-s dhe ZRRE, shqyrtuan dhe vendosën mbi caktimin e shoqërisë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - Albanian Power Exchange sha-ALPEX, si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO). Brenda 2 (dy) muajve nga ky vendim, shoqëria “ALPEX” sha, duhet të depozitohet në ERE Programin Ekonomik të vitit 2023 të ndryshuar të miratuar nga organet drejtuese të saj si



dhe argumentimet lidhur me strukturën organizative të propozuar.

Përcaktimi i NEMO-s mbetet i vlefshëm deri në transpozimin e Rregullores së Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestionëve në legjislacionin e vendit, sipas të cilës përcaktimi i NEMO duhet të konfirmohet bazuar në këtë rregullore.



Gjatë mbledhjes, kryetarët z. Ahmeti dhe z. Fejzullallu nënvizuan rëndësinë e nominimit të NEMO-s i cili do të operojë tregun e përbashkët të energjisë elektrike të një dite më parë të Shqipërisë dhe Kosovës.